

Letër Këshilluese 2007-2

Nëntor 2007

Aktivitetet Koresponduese

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj letre këshilluese është që të ju ofrojë bankave udhëzime në lidhje me aktivitetet koresponduese. AQBK-ja pret që bankat do të zhvillojnë ose plotësojnë politikat, praktikat dhe sistemet e tyre në mënyrë që të jenë në pajtim me këto udhëzime.

Gjatë kursit të kryerjes së aktivitetit të mbikqyrjes Autoriteti Qendror Bankar i Kosovë (AQBK) ka vërejtur se bankat në Kosovë janë të ekspozuara në nivele të ndryshme, kryesisht përmes aktiviteteve koresponduese, ndaj bankave të huaja. Shumica e këtyre marrëdhënieve kanë qenë të themeluara që moti dhe mund të jenë të matura, por në pikëpamje të rritjes së problemeve në tregun financiar ndërkombëtar, posaqërsisht në disa institucione të mëdha në këto tregje, ekspozime të caktuara tani mund të paraqesin rrezik të papërshtatshëm.

UDHËZIMET

AQBK-ja ju këshillon që të shqyrtoni ekspozimet e juaja ndërbankare që të dyja duke përfshirë edhe ato jashtëbilancore në pikëpamje të rasteve momentale. Ju jeni të nxitur që të siguronit se ekspozimet janë vetëm ndaj institucioneve obligimet e të cilave janë të klasifikuar jo më ulët se “shkalla e investimeve” nga ana e agjensioeneve të njohura të vlerësimit/klasifikimit. Duke marrë parasysh kohëve të fundit shpejtësinë e rrënjes së klasifikimeve institucionale, bankat janë të shtyera që të fillojnë një “kujdes të përshtatshëm”/“due diligence” të tyre ndaj bankave koresponduese në mënyrë që të sigurohen se vlerësimi i rrezikut të tyre është aktual. Marrëdhëniet me institucionet të cilat nuk janë të kalsifikuara duhet të jenë subjekt i vëzhgimit. AQBK do të shqyrtojë në mënyrë më kritike ekspozimet ndërbankare gjatë ekzaminimit të saj, dhe do të shikojë në dokumentacionin adekuat për vendimin e marrë nga bankat sa i përket zgjedhjes dhe nivelit të ekspozimeve ndaj pales së kundërt. Vëmendja e juaj është e drejtuar veqanërisht në kërkesat e Rregullës bankare II për limitin dhe koncentrimin e kredive.

Sinqerisht i juaji,

Michel Svetchine
Drejtor Gjeneral

